



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO | REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCEZI PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5. dhe nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (tutje: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), nenit 11 paragrafi 4 dhe 5, si dhe nenit 12 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7. të Rregullores Nr. 03/2023, për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 27.06.2024, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- Mbylljet rasti APK-DPKI-06-296/24, për zyrtarin e lartë z. Arbëri Sadiki, Drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.
- Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjtë publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesit për zyrtarin e lartë publike z. Arbëri Sadiki, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka filluar trajtimin e këtij rasti pas pranimit të një informate me shkrim (DPKI-06-296/24), me pretendimin "... për konflikt të interesit në rastin e z. Arbëri Sadiku, i cili në cilesi të Drejtorit të Urbanizmit në Komunën e Prishtinës, ka marrë pjesë në vendimmarrje në konflikt të interesit duke nënshkruar "Certifikatën e Përdorimit" për ndërtesën për të cilën paraprakisht në cilesi të profesionistit privat ka punuar raportin përfundimtar të punimeve të arkitekturës, e që sipas raportuesit edhe projektit i ndërtesës në fjalë me të cilin kishte aplikuar për leje ndërtimi në vitin 2016, ishte bërë nga kompania "P-Delta" SH.P.K., që për pronarë aktualisht ka B.S. dhe A.P., por pjesë e kompanisë në atë kohë ishte edhe z. Arbëri Sadiki. Sipas informatave të raportuesit, drejtori Arbëri Sadiki ka nënshkruar edhe një leje të ndërtimit për ndërtesën shumë banesore & afariste e cila po ngritet në lagjen 'Mati 1' në Prishtinë. Investitor është kompania "Maloku Group," sh.p.k nga Prishtina, ku rezulton se hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtesën e ka bërë kompania "G + A Architects", në të cilën kompani Arbëri Sadiki ka deklaruar se zotëron 50% të aksioneve, dhe atë referua deklarimit të pasurisë nga Arbëri



Sadiki në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit. Gjithashtu, sipas këtyre informatave, në mars të vitit 2022, kompania "G + A Architects" ka lidhur një kontratë me Universitetin e Prishtinës me titull "Hartimi i Projekteve për Ndërtim, Objekte shtesë, Renovim dhe Shqyrtim Profesional i konstrukcionit nga Aspekti i Stabilitetit dhe Funksionalitetit te UP-së". Gjate realizmit të kësaj kontrate, kompania fituese e tenderit do të ketë punë edhe me ish-pronarin e vet, Arbër Sadiki, ku pasi shumica e ndërtesave ndodhen në Prishtinë dhe për të marrë një leje ajo duhet të lëshohet nga Drejtoria e Urbanizmit të Prishtinës.

Në pajtim me nenin 22, paragrafin 3, dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit (DPKI-06-687/24).

Lidhur me pretendimet si më lartë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, përmes shkresës zyrtare ka kërkuar dhe pranuar informacione/dokumentacionet përkatëse (APK-DPKI-06-612/24) nga Komuna e Prishtinës, si dhe nga z. Arbër Sadiki (DPKI-06-913/24).

Me qëllim të sqarimit të plotë dhe të gjithanshëm të këtij rasti, në ambientet e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit është realizuar një takim me z. Arbër Sadiki, ku janë diskutuar dhe shtjelluar çështjet që kanë të bëjnë me rastin në fjalë, ndërsa i njëjtë ka paraqitur sqarimet e tij lidhur me rastin pretendimet e ngitura.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, konform kompetencave të përrekuara me Ligjin Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka shqyrtuar pretendimet e raportuesit të rastit, pastaj informatat/dokumentacionin e siguruara nga Komuna e Prishtinës si dhe sqarimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga z. Sadiku, e sipas të cilave rezulton se:

Sa i përket pretendimit të pare, se z. Arbër Sadiku, i cili në cilësi të Drejtorit të Urbanizmit në Komunën e Prishtinës, ka marrë pjesë në vendimmarrje në konflikt të interesit duke nënshkruar "Certifikatën e Përdorimit" për ndërtesën përfundimtar të cilën paraprakisht në cilësi të profesionistit privat ka pumuar raportin përfundimtar të punimeve të arkitekturës, e që si pas raportuesit edhe projekti i ndërtesës në fjalë me të cilin kishte aplikuar për leje ndërtimi në vitin 2016, ishte bërë nga kompania "P-Delta" SH.P.K., që për pronarë aktualisht ka B.S. dhe A.P., por pjesë e kompanisë në atë kohë ishte edhe z. Arbër Sadiki. Agjencia konstaton si në vijim:

Në vitin 2016, z. Arbër Sadiki, me Vendimin e kompanisë "P-Delta" SH.P.K., ishte caktuar si hartues i raportit për projektin e Arkitekturës, i cili në këtë cilësi kishte përgatitur dhe nënshkruar Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës përfundimtar të objektit me leje 05. Nr. 05-351-33403, datë 17.08.2016, me investitor 'Nardi-Alkolimpex' SH.P.K. Pastaj, me datën 01.02.2023 në cilësinë e Drejtorit të Urbanizmit të Komunës së Prishtinës, z. Sadiki ka nënshkruar Certifikatën e Përdorimit Nr.05NR. 391/02-140799/22, për objektin e njëjtë ndërtimor.

Në rastin konkret, pjesëmarja e z. Sadiki në nxjerjen/nënshkrimin e Certifikatës së Përdorimit si më lartë, nuk bie ndesh me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, pasi që konflikti i interesit lidhet me vendimmarrjen e personit zyrtarë në një çështje të caktuar në të cilën ai ose ndonjë anëtar i familjes kanë interes privat, ashtu siç është

përcaktuar me nenin 6 [Konflikti i Interesit] të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, sipas të cilit:

"Konflikti i interesit lind nga një rrrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare.", në lidhje me nenin 3 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2. i cili përcakton se: *"Interes privat i personit zyrtar – nenkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënien afariste".*

Andaj, referuar dispozitës si më lartë dhe sipas shkresave të lëndës, z. Sadiku raportin e tillë ka përgatitur në cilësi të profesionistit të angazhuar nga kompania "P-Delta" e cila kishte përgatitur projektin e ndërtuesës së investitorit "Nardi-Alkolimpex", për të cilën z. Sadiku në cilësi të drejtorit të urbanizmit ka nënshkruar "Certifikatën e Përdorimit". Rrjetimisht, z. Sadiku nuk ka qenë në marrëdhënje afariste/biznesore me "Nardi-Alkolimpex", kur e ka përgatitur raportin për projektin e arkitekturës, por vetëm pjesë e kompanisë "P-Delta", e cila nuk ka pasur interes me rastin e lëshimit të "Certifikatës së Përdorimit" për kompaninë "Nardi-Alkolimpex".

Lidhur me pretendimin e raportuesit se, drejtori Arbëri Sadiki ka nënshkruar edhe një leje të ndërtimit për ndertesen shumë banesore & afariste e cila po ngritet në lagjen 'Mati I' në Prishtinë. Investitor është kompania "Maloku Group" sh.p.k nga Prishtina, ku rezulton se hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndertesën e ka bërë kompania "G + A Architects", në të cilën kompani Arbëri Sadiki ka deklaruar se zoteron 50% të aksioneve, dhe atë referua deklarimit të pasurisë nga Arbëri Sadiki në Agjencinë për Parandalimin e Korruptionit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës Agjencia konsiaton se:

Sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me vendimmarjen e zyrtarit në një çështje të caktuar në të cilën ai apo anëtarët e familjes kanë interes privat, ashtu siç përcaktohet në nenin 6 të këtij ligji, sipas të cilit *"Konflikti i interesit lind nga një rrrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare."*

... në lidhje me nenin 3 paragrafi 1.6. sipas të cilit: *"Person i afërmi me zyrtarin – bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmni në gjini të krushqisë deri në shkallën e dyte si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interes i privat pasur ose jopasur me zyrtarin. Për qëllime të ketij ligji, personi juridik konsiderohet si person i afërmi, sipas dispozitive të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.* Lidhur me këtë, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, në nenin 417, paragrafi 5 ka përcaktuar se: *"Për qëllime të ketij nen, shprehja "person juridik që ka të bëjë me të" - nenkupton personin juridik në të cilin zyrtari apo anëtarë i familjes ka marrëdhënje financiare*

aktuale apo tē ardhshme, përfshire marredhenien afariste ose tē punës apo dobi financiare tē qfarëdo natyre.

Në rastin konkret, në fryshtave dispozitave si më lartë dhe sipas shkresave të lëndës nuk është gjetur që z. Sadiku, të ketë pasur interes privat me rastin e nënshkrimit të lejes së ndërtimit të theksuar në pretendimin e raportuesit. Kjo përfaktin se sipas këtyre dispozitave, kompania "Maloku Group" përf tē cilën është lëshuar leja e ndërtimit nuk konsiderohet person i afërm me z. Sadiki.

Pastaj, bazuar në informatat e siguruara nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve, përkizazi me kompaninë "G&A Architects", nuk figuron që z. Sadiku të ketë pasur pronësi në këtë kompani në kohën kur është lëshuar leja e ndërtimit përf kompaninë "Maloku Group".

Gjithashtu, sipas një kërkesë të z. Sadiku, drejtar Zyrës Ligjore të Komunës së Prishtinës (DPKI-913/24) lidhur me çështjen e nënshkrimit të vendimeve, e njëjtë kishte nxjerr interpretimin sipas të cilit: "... *bazuar në dispozitat ligjore që rregullojnë procedurën administrative, Zyra Ligjore konsideron se Drejtori i një Drejtorie nuk ka obligim të nënshkruaj vendimet te cilat vendosin përf kérkesën e palës, por këtë mund ta bëjë cili do zyrtar të cilit paraprakisht i është deleguar si detyrë nga udhëheqësi i tij, trajtimi dhe vendosja përf një kérkesë të caktuar*".

Ndërsa, lidhur me pretendimin se: *në mars të vitiit 2022, kompania "G + A Architects" ka lidhur një kontratë me Universitetin e Prishtinës me titull "Hartimi i Projekteve përf Ndërtim, Objekte shtesë, Renovim dhe Shqyrtim Profesional i konstruksionit nga Aspekti i Stabilitetit dhe Funksionalitetit te UP-së". Gjatë realizmit të kësaj kontrate, kompania fituese e tenderit do të ketë punë edhe me ish-pronarin e vet, Arbër Sadiki, ku pasi shumica e ndërtesave ndodhen në Prishtinë dhe përf tē marrë një leje ajo duhet të lëshohet nga Drejtoria e Urbanizmit të Prishtinës, Agjencia nuk lëshohet në interpretimin e situatave apo rasteve (hipotetike) të cilat mund të ndodhin në tē ardhmen.*

Pretendimet si më lartë janë trajtuar vetëm në kontekst të dispozitave të Ligjit përf Parandalimin e Konflikti të Interesit.

II. Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia përf Parandalimin e Korruptionit lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik janë përfundimtare në procedurën administrative, dhe bëhen publike në faqen zyrtare të Agjencisë, konform nenit 22, paragrafi 12 të Ligjit përf Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)

VII Buleshkaj

 Drejtor i Agjencisë
 përf Parandalimin e Korruptionit